

VENDIM
Nr. 48, datë 7.11.2017

**PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË SHITJES SË UJIT ME SHUMICË PËR SHOQËRINË
UJËSJELLËS URA VAJGURORE SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12. 2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së shitjes së ujit me shumicë për shoqërinë Ujësjiellës Ura Vajgurore sh.a.:

a) Tarifë shitjeje uji me shumicë 29 lekë/m³

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani